



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13. 04. 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MS/CK	2077/2022		1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.295/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.313/2020 të datës 09.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.605/2019 të datës 04.10.2019 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me Nr. Prot:10553 të datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.605/2019 e datës 04.10.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. Prot:10553 i datës 27.09.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë lëshimin e Akt Emërimit për ankuesen në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 21.06.2019, me datë 25.06.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar Administrativ- 2 pozita". Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit. Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më datë 23.07.2019 ka publikuar njoftimin për kandidatët e suksesshëm në bazë të të cilit kandidatë të suksesshëm janë znj. B.G dhe znj. F.I. Më datë 23.08.2019 nëpërmjet e-mailit Z.A në emër të Sekretarit të Përgjithshëm ka kërkuar nga V.S të anulohet konkursit për të cilën deri më tani nuk është nënshkruara Akt emërimi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, më datë 27.08.2019 ka bërë anulimin e konkursit të lartcekur, mirëpo që nuk janë dhënë arsyet e anulimit. Kundër anulimit të konkursit, ankuesja më datë 28.08.2019 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 9339 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, më datë 27.09.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:10553 me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. Prot:10553 të datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4652/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.10.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit më datë 18.11.2019 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 12.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 09.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.313/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 12.11.2019 dhe duke e

detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 04.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4652/2019 të datës 04.10.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin për pozitën "Zyrtar Administrativ" i shpallur më datë 25.06.2019 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit; E-mailin e datës 16.07.2019, 18.07.2019 dhe 23.07.2019 për ankuesen; Ankesën e datës 28.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me Nr. Prot:10553 të datës 27.09.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit; Njoftimin i kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë; Njoftim i kandidatëve mbi përzgjedhjen e kandidatit; Vendimin me Nr. Prot: 7535 i datës 15.07.2019 për emërimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës; Njoftim i datës 15.07.2019 nga B.D dhe V. C; Ftesë e datës 18.07.2019, 16.07.2019; Formularin Form. MAP-SHCK-04 për Regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 03.06.2019; Autorizimin e Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 21.06.2019; Kërkesën e datës 23.08.2019 nga Z.A për V.S; E-mailin e datës 26.08.2019 nga V.S; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 23.07.2019; Aprovimi mbi përzgjedhjen e kandidatit; Raporti i komisionit përzgjedhës për krijimin e listës së ngushtë dhe intervistimin e kandidatëve datë 22.07.2019; Anulimin e konkursit i datës 27.08.2019; Të dhënat për zgjedhjen e ngushtë; Formularin Form. MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Formularin Form. MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form. MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formularin Form. MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formularin Form. MAP-SHCK-11 i raportit final i rekomandimit nga komisioni rekrutues; Formularin Form. MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim i datës 19.07.2019 për ankuesen dhe kandidatët tjerë; Kërkesën për punësim të ankueses dhe kandidatëve të tjerë; Përgjigjen në ankesë e datës 18.11.2019; E-mailin e datës 01.11.2019, 18.11.2019 nga A. B për V.S; E-mailin e datës 20.11.2019 nga V.S për A. B; Njoftimin e datës 12.11.2019 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.313/2020 të datës 09.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që ka aplikuar në pozitën "Zyrtar Administrativ-2 pozita" duke ju nënshtruar të gjitha procedurave dhe përzgjedhjes dhe pasi që nuk ka pasur asnjë ankesë gjatë këtij procesi befasisht është anuluar konkursit pa shpjegim; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit është i kundërligjshëm sepse kandidatja tjetër cila është përzgjedh të njëjtën pozitë ka marr akt emërim dhe cili është faji im pse nuk është nënshkruar akt emërimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që ka aplikuar në pozitën "Zyrtar Administrativ-2 pozita" duke ju nënshtruar të gjitha procedurave dhe përzgjedhjes dhe pasi që nuk ka pasur asnjë ankesë gjatë këtij procesi befasisht është anuluar konkursi pa shpjegim, ka konstatuar që ankuesja ka aplikuar në konkursin për pozitë dhe ka plotësuar kushtet e konkursit dhe përfshirja e saj në listë të shkurtër është bërë në pajtim me nenin 28 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa që edhe procedurat tjera si lista e shkurtër, testi me shkrim, me gojë dhe njoftimi për kandidatin e suksesshëm është bërë në pajtim me nenin 26, 32, 36, 38 dhe 40, 41 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si rrjedhojë në këtë procedurë nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale e cila do ta bënte këtë pozitë të pavlefshme, kështu që anulimi i konkursit më datë 27.08.2019 është bërë pa dhënë arsye konkrete se cilat janë shkaqet e anulimit të konkursit, ndërsa që Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil përcakton qartë cilat do të jenë shkaqet për anulimin të një konkursi, për më tepër njoftimin për anulim nuk është i arsyetuar sipas Ligjit Nr. 05/1-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit është i kundërligjshëm sepse kandidatja tjetër e cila është përzgjedh të njëjtën pozitë ka marr akt emërim dhe cili është faji im pse nuk është nënshkruar akt emërimi, ka konstatuar se meqenëse në njoftimin për anulim të konkursit nuk janë dhënë arsyetime mbi anulimin e tij, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit në vendimin e tij të datës 27.09.2019 ka dhënë arsyetim që procedura e rekrutimit është anuluar për arsye që Akt Emërimi ankueses nuk i është lëshuar brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit, si rrjedhojë në procedurën e rekrutimit për pozitën "Zyrtar Administrativ-2 pozita" në bazë të njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 23.07.2019 janë përzgjedhur dy kandidat në mesin e tyre edhe ankuesja, mbi këtë bazë institucioni respektivisht Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka qenë e obliguar që ankueses t'i lëshoj akt emërimin në pajtim me nenin 19 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil"* dhe nenin 41 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, pasi që e gjithë procedura ka përfunduar dhe nuk ka pasur ndonjë ankesë gjatë procesit, kështu që arsyetimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve i Ministrisë së Transportit se anulimi i konkursit është bërë pasi që nuk është lëshuar akt emërimi brenda 30 ditëve është arsyetim jo i saktë dhe jo ligjor pasi që vonesat janë shkaktuar nga vetë institucioni. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për të provuar pretendimin e ankueses se kandidates tjetër e cila është përzgjedh të njëjtën pozitë i është lëshuar akt emërim, më datë 18.11.2019 kemi kërkuar prova nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit *"të na dërgohet Akt Emërimi i kandidates tjetër i nënshkruar"*, ndërsa më datë 20.11.2019 jemi njoftuar se: *"Bazuar në kërkesën tuaj lidhur me ankesën e znj. ku keni kërkuar Akt Emërimin e kandidates tjetër të nënshkruar, ju informoj se Akt Emërimi i kërkuar nuk është objekt i ankesës në fjalë"*, si rrjedhojë e përgjegjës

së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit kemi konstatuar që nuk është mohuar që ka një akt emërim të tillë dhe mos dërgimi i akt emërimit është mos bashkëpunim i ministrisë me Këshillin edhe pse janë të obliguara sipas nenit 25 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin”*, për më tepër Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kompetencë të *ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil*, siç përcaktohet me nenin 7 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi këtë bazë lëshimi i akt emërimit për vetëm njërin kandidatë ndërsa për kandidaten tjetër jo është vendosje sipas standardit të dyfishtë dhe diskriminim ndaj ankueses e që është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. Prot:10553 të datës 27.09.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave duke mos arsyetuar vendimin sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankueses janë të bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të gjitha shqyrtimit të provave të lëndës konstaton që Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është i obliguar që në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, të bëjë lëshimin e Akt Emërimit për pozitën “Zyrtar Administrativ” për ankuesen.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit dhe personat kompetent i ndërmarrin veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.295/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

